



112/3

2282

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇËSHTJEVE SOCIALE
SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 4556/Prot.

Ballsh, më 04.10.2023

Lenda : Kthim përgjigje shkresës me nr. 1534/1Prot., datë 25.09.2023

**KOMISIONERIT PËR TË DREJTAT E INFORMIMIT DHE MBROJTJES SË TË
DHËNAVE PERSONALE**

Për dijeni: **QENDRËS 'RES PUBLICA'**

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. Prot. 1534/1 datë 25.09.2023 "Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare", administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr.387 Prot., datë 27.09.2023, ju bëjmë me dije se:

Emaili i dërguar nga Qendra 'Res Publica' ne emailin zyrtar të Bashkisë Mallakastër ka ardhur si Spam (dokumenti bashkangjitur) ne email, nuk kemi qënë në dijeni për emailin e ardhur deri në momentin që ka ardhur shkresa nga ana juaj dhe nuk për këtë arsye nuk ka pasur një përgjigje nga ana e bashkisë për informacionin e kërkuar nga Qendra.

Për informacionin që kërkohet nga qendra ju informojmë se në Bashkinë Mallakastër gjatë muajit shtator janë trajtuar 427 familje me ndihme ekonomike nga sistemi i ndihmës ekonomike. Numri i familjeve që kanë përfituar nga fondet e 6% janë 51 familje, nga të cilat 31 prej tyre trajtohet nga fondet e buxhetit qendror dhe 20 familje nga fondet e buxhetit vendor.

Duke ju falënderuar për bashkepunimin.

